

Mjetet alternative të mbarështimit të bimëve duke përdorur sistemet ekogeografike të informacionit

BELUL GIXHARI¹

¹ Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve (Universiteti Bujqësor i Tiranës), Shqipëri.

Abstrakt

Studimi i paraqitur rishikon përdorimin e informacionit ekogeografik (mjedisor) në përdorimin efikas të burimeve gjenetike të bimëve. Ndërsa informacioni gjenotipik fitoi një hov të shpejtë në studimet e agrobiodiversitetit gjatë dy dekadave të fundit, përdorimi i informacionit mjedisor në vendet e mbledhjes ka ecur në hapa më gradualë, megjithëse ambienti, që nga fillimi i bujqësisë, është konsideruar në mënyrë empirike si një faktor kryesor nga fermerët dhe mbarështuesit konvencionalë të bimëve. Aktualisht informacioni mjedisor në vendet e grumbullimit (karakterizimi ekogeografik) zbulon shtrirjen e përshtatshmërisë së gjenotipeve të specieve të ruajtura dhe identifikon faktorët më të rëndësishëm mjedisorë për përshtatje. Përdorimi i sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) ndihmoi në përparimin e karakterizimit ekogeografik dhe rregullimin e të dhënave mjedisore në formate të përputhshëm me aplikimet GIS. Sistemet e informacionit gjeografik janë të dobishëm për të menaxhuar dhe analizuar të dhënat e gjeoreferencave të vendeve të mbledhjes, të tilla si të dhënat e pasaportës së koleksionimit dhe variablat mjedisorë, duke bërë të mundur studimin e kushteve mjedisore në të cilat të afërmit e egër të kulturave dhe varietetet lokale, kanë fituar tiparet e tyre të përshtatshmërisë. Këto mund të përmirësojnë efikasitetin e aktiviteteve tipike të ruajtjes dhe përdorimit të burimeve gjenetike të bimëve, të tilla si mbledhja dhe eksplorimet në terren, identifikimi i boshllëqeve dhe zonave me përparësi për ruajtje, duke krijuar koleksione bërthamë ose përzgjedhjen e gjermoplazmës së duhur për programet e mbarështimit të bimëve.

Fjalë kyçe: karakterizimi ekogeografik, mjedisi, informacioni gjenotipik.